



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE
SPORTIT
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY
SEKTORI I ARSIMIT DHE SPORTIT
No. pages: 01/B
Nr. fageve: 4061
Br. stranic: 19.12.24
Prishtine



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe
Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja,
Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of
Education, Science, Technology and Innovation

Nr. 7242/2 Prot., datë 02.12.2024

Nr. 243 Prot., datë 19.12.2024

URDHËR/VENDIM I PËRBASHKËT

NR 1, DATË 02.12.2024

PËR

MIRATIMIN E AKTEVE RREGULLATORE NË ZBATIM TË MARRËVESHJES “PËR
REALIZIMIN E OLIMPIADËS SË PËRBASHKËT NË LËNDËN “GJUHË SHQIPE”,
KLASA E 9-TË, ARSIMI I MESËM I ULËT PARAUNIVERSITAR”

Në mbështetje të nenit 3 të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës për realizimin e olimpiadës së përbashkët në lëndën “Gjuhë shqipe”, klasa e 9-të, arsimit i mesëm i ulët parauniversitar, datë 05.07.2023, Urdhrit nr. 556, datë 02.10.2023 “Për caktimin e përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në grupin e përbashkët të punës për realizimin e olimpiadës së përbashkët në lëndën “Gjuhë Shqipe”, klasa e nëntë, arsimit i mesëm i ulët parauniversitar”, Vendimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, nr. 01B-046, dt. 08.05.2024 “Për emërimin e grupit punues”,

URDHËROJ/VENDOS:

1. Miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të grupit të punës, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri/vendimi.
2. Miratimin e kalendarit të punës për zhvillimin e olimpiadës, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri/vendimi.

3. Miratimin e rregullores për realizimin e olimpiadës së përbashkët në lëndën “Gjuhë shqipe”, klasa e 9-të, arsimit i mesëm i ulët, sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri/vendimi.
4. Miratimin e kornizës së përbashkët të programeve të gjuhës shqipe për realizimin e olimpiadës në lëndën e gjuhës shqipe, me nxënësit e klasave të 9-ta në Kosovë dhe në Shqipëri, sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri/vendimi.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri/vendimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar/Drejtoritë Komunale të Arsimit, institucionet arsimore parauniversitare (shkollat) dhe grupet respektive të punës.

Ky urdhër/vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Ogerta MANASTIRLIU



MINISTËR

Arbërie NAGAVCI



Shtojca nr. 1

R R E G U L L O R E
PËR FUNKSIONIMIN E GRUPIT TE PUNËS PËR
REALIZIMIN E OLIMPIADËS SË PËRBASHKËT NË LËNDËN “GJUHË SHQIPE”
KLASA E 9-TË, ARSIMI I MESËM I ULËT PARAUNIVERSITAR”

Baza ligjore

Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës (MASHTI) “Për realizimin e olimpiadës së përbashkët në lëndën “Gjuhë shqipe”, klasa e 9-të, arsimit i mesëm i ulët parauniversitar”, nënshkruar në datë 5.7.2023; Urdhri i MAS-it, nr. 556, datë 2.10.2023 “Për caktimin e përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në Grupin e Përbashkët të punës, për zhvillimin e olimpiadës së përbashkët në lëndën “Gjuhë shqipe”, klasa e 9-të, arsimit i mesëm i ulët parauniversitar”, si dhe Vendimi i MASHTI-it numër: 01B- 046, datë 8.5.2024 “Për emërimin e grupit të punës”, të Ministrit të Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës.

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka si qëllim përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së Grupit të Përbashkët të punës, për procesin e realizimit të olimpiadës së përbashkët në lëndën “Gjuhë shqipe”, klasa e 9-të, arsimit i mesëm i ulët parauniversitar.

Neni 2
Detyrat e Grupit të Përbashkët

1. Grupi i përbashkët do të organizojë dhe koordinojë të gjitha veprimtaritë për realizimin e olimpiadës në lëndën “Gjuhë shqipe”, klasa e nëntë, arsimit i mesëm i ulët parauniversitar, si dhe do të hartojë paketën e dokumenteve për këtë olimpiadë. Ky grup, bazuar në legjislacionin e të dyja vendeve, ka për detyrë:
 - a) miratimin e kalendarit të veprimtarive për olimpiadën e përbashkët në lëndën “Gjuhë shqipe”, klasa e 9-të;
 - b) ndjekjen dhe realizimin e të gjitha veprimtarive të dakordësuara në planin e përbashkët të punës të miratuar nga të dy grupet e punës;
 - c) miratimin e mënyrës së zhvillimit të olimpiadës;
 - d) hartimin dhe miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të grupit të përbashkët të punës;
 - e) hartimin e rregullores për zhvillimin e olimpiadës së përbashkët në lëndën “Gjuhë shqipe”, me nxënës të klasave të nënta;

- f) hartimin e kornizës së përbashkët të programeve të gjuhës shqipe, të klasës së nëntë të të dy vendeve, mbi bazën e së cilës do të hartohet fondi i pyetjeve dhe testimi i nxënësve pjesëmarrës në këtë olimpiadë;
- g) përgatitjen e dokumentacionit për miratim nga ministrat përgjegjës të arsimit, sipas parashikimeve të Memorandumit të Mirëkuptimit;
- h) publikimin në faqet zyrtare të institucioneve të të dy vendeve të rregullores së olimpiadës, kornizës së përbashkët të programeve të gjuhës shqipe, të klasave të 9-ta, pas miratimit nga ministrat përgjegjës;
- i) njoftimin e të gjitha institucioneve arsimore parauniversitare të të dyja vendeve për procedurat dhe afatet e realizimit të olimpiadës;
- j) mbikëqyrjen e të gjitha fazave dhe procedurave për realizimin e olimpiadës dhe hartimin e raportit përfundimtar të veprimtarisë nga secili grup pune;
- k) organizimin e procedurave për hartimin e pyetjeve të olimpiadës për fazën IV, realizimin dhe monitorimin e testimit, vlerësimin e përgjigjeve dhe shpalljen e rezultateve;
- l) organizimin dhe realizimin e ceremonisë së dhënies të certifikatave të fituesve;
- m) informimin e ministrave përgjegjës për arsimin, në përfundim të të gjitha fazave të zhvillimit të olimpiadës, si dhe sa herë që kërkohet nga ana e tyre;
- n) shkëmbimin në kohë të çdo informacioni të nevojshëm në përmbushje të qëllimit të Memorandumit të Mirëkuptimit.

Neni 3

Të drejtat dhe detyrat e anëtarit të Grupit të Përbashkët

1. Anëtari i Grupit të Përbashkët ka të drejtat e mëposhtme:
 - a) të njihet me çdo dokument që lidhet me çështjen për të cilën do të marrë vendim;
 - b) të shprehë lirshëm mendimin e tij.
2. Anëtari i Grupit të Përbashkët ka detyrimin:
 - a) të marrë pjesë rregullisht në takime;
 - b) të ushtrojë funksionet e tij me profesionalizëm dhe përgjegjshmëri;
 - c) të ruajë konfidencialitetin për çështjet, dokumentet dhe faktet për të cilat ka marrë dijeni për shkak të detyrës;
 - ç) të deklarojë dhe të shmangë çdo situatë të konfliktit të interesit;
 - d) të votojë, por në rast votimi kundër, ta arsyetojë vendimmarrjen.

Neni 4

Takimet e Grupit të Përbashkët

1. Takimet organizohen sipas agjendës, të caktuar nga kryetarët e Grupit të Përbashkët. Takimet bashkëdrejtohen nga dy kryetarët. Në rastet kur mungon njëri nga kryetarët dhe janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të të dyja palëve, takimi drejtohet nga kryetari tjetër. Në mungesë të të dy kryetarëve, mbledhja drejtohet nga njëri prej anëtarëve të autorizuar nga ata.
2. Të gjithë anëtarët e grupit të përbashkët marrin pjesë në takime, siç përcaktohet në këtë rregullore.

3. Takimet zhvillohen me praninë e numrit të nevojshëm anëtarëve për vendimmarrje.
4. Përpara fillimit të takimeve të Grupit të Përbashkët, anëtarët nënshkruajnë në listën e pjesëmarrjes, e cila është pjesë shoqëruese e procesverbalit. Anëtari i grupit të punës mund të mungojë për shkaqe të arsyeshme, por duhet të njoftojë paraprakisht për mos-praninë e tij në takime.

Neni 5 **Vendimmarrja**

1. Pas shqyrtimit dhe përfundimit të diskutimeve, Grupi i Përbashkët merr vendime për çështjet e diskutuara gjatë takimeve.
2. Vendimet e Grupit të Përbashkët miratohen me 3/4 e të gjithë anëtarëve.
3. Vendimi nënshkruhet në çdo faqe nga kryetarët dhe anëtarët. Vendimi përgatitet në tri kopje dhe protokollohet në MAS dhe në MASHTI.

Neni 6 **Mbajtja e procesverbalit**

1. Kryetarët e grupit të punës në fillim të çdo mbledhjeje caktojnë një anëtar për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes.
2. Në përfundim të takimit, procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e grupit të përbashkët të punës.

Shtojca nr. 2

KALENDARI I VEPRIMTARIVE TË OLIMPIADËS	
1	Miratimi i Kalendarit të Veprimtarive për Olimpiadën e Përbashkët (OP) të Lëndës së Gjuhës Shqipe – Klasa e 9-të.
2	Miratimi i formës së zhvillimit të olimpiadës.
3	Hartimi dhe miratimi i rregullores së organizimit dhe funksionimit të grupit të punës.
4	Hartimi i rregullores për zhvillimin e olimpiadës së përbashkët në lëndën e gjuhës shqipe me nxënës të klasave të nënta.
5	Hartimi i kornizës së përbashkët të programeve të gjuhës shqipe të klasës së nëntë të të dy vendeve në funksion të realizimit të olimpiadës.
6	Miratimi me urdhër të përbashkët nga ministrat përgjegjës të arsimit të rregullores së olimpiadës, kornizës së programeve të gjuhës shqipe për zhvillimin e olimpiadës, datës dhe vendit.
7	Shpallja e rregullores, kornizës së përbashkët të programeve të gjuhës shqipe të klasave të 9-ta, për organizimin e olimpiadës së përbashkët.
8	Informimi i mësuesve e institucioneve në të dy vendet me rregulloren e olimpiadës, kornizën e përbashkët të programeve të gjuhës shqipe për të cilat do të realizohet olimpiada dhe kalendarin e olimpiadës
9	Trajnimi i hartuesve dhe vlerësuesve të testeve të të gjitha fazave. Anëtarët e secilit shtet trajnojnë hartuesit e pyetjeve të shtetit respektiv për fazat I, II dhe III, ndërsa për fazën IV trajnohen nga të gjithë anëtarët e caktuar në kalendar.
10	Hartimi i pyetjeve të olimpiadës për fazën e I (në nivel shkolle), mbi bazën e kornizës së propozuar nga GP dhe miratuar nga ministrat.
11	Zhvillimi i fazës së parë të olimpiadës në nivel shkolle. Kjo fazë organizohet në çdo shkollë të arsimit 9-vjeçar.
12	Vlerësimi i testeve të fazës I nga vetë shkollat dhe përcaktimi i nxënësve fitues për në fazën II sipas rregullores. Shpallja e fituesve të fazës parë dhe dërgimi i listës së fituesve në ZVAP/DKA.
13	Hartimi dhe shumëfishimi i testeve të olimpiadës për fazën II.
14	Realizimi i fazës së dytë të olimpiadës në nivel ZVAP-je, DKA-je, ku marrin pjesë nxënësit fitues në nivel shkolle. Kjo fazë organizohet në mjedisin e caktuar nga ZVAP/DKA.
15	Vlerësimi i testeve të fazës II dhe dërgimi i fituesve për të marrë pjesë në fazën III. Shpallja e fitueseve të fazës dytë, njohja e shkollave me rezultatet për nxënësit e tyre dhe dërgimi në MAS/MASHT.
16	Hartimi dhe shumëfishimi i testeve të vlerësimit të olimpiadës për fazën III të olimpiadës në nivel shteti.
17	Zhvillimi i fazës së tretë të olimpiadës në nivel shteti në Tiranë dhe Prishtinë me pjesëmarrjen e nxënësve fitues të fazës së dytë. Kjo fazë organizohet në mjedisin e caktuar nga MAS/MASHTI.

18	Vlerësimi i tezave të fazës III nga grupet e punës dhe publikimi i nxënësve fitues sipas përcaktimeve në rregullore. Shpallja e fitueseve për fazën e katër të olimpiadës së përbashkët.
19	Hartimi i pyetjeve për fazën e katër të olimpiadës së përbashkët Shqipëri-Kosovë.
20	Zhvillimi i fazës së katër të olimpiadës së përbashkët Shqipëri-Kosovë, me pjesëmarrjen e nxënësve fitues të fazës së tretë në nivel shteti. Në vitin shkollor 2024-2025 faza e katër (finale) do të zhvillohet në Tranë në mjedisin e caktuar nga MAS.
21	Vlerësimi i tezave të fazës IV. Shpallja e fitueseve për fazën e katër të olimpiadës së përbashkët.
22	Ceremonia e shpërndarjes së certifikatave të fituesve të fazës IV, në Tiranë.

RREGULLORE
PËR
REALIZIMIN E OLIMPIADËS SË PËRBASHKËT NË LËNDËN GJUHË SHQIPE,
KLASA E 9-TË, ARSIMI I MESËM I ULËT

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

Kjo Rregullore përcakton rregullat për organizimin dhe zhvillimin e olimpiadës së përbashkët në lëndën “Gjuhë shqipe”, klasa e 9-të, arsimit i mesëm i ulët, si dhe përcakton institucionet shtetërore dhe strukturat përgjegjëse për realizimin e këtij procesi.

Neni 2

Qëllimi i olimpiadës

Olimpiada ka për qëllim nxitjen e nxënësve për mësimin e gjuhës amtare, nxjerrjen në pah të prirjeve dhe talenteve në lëndën e gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët, si dhe promovimin e vlerave të gjuhës sonë kombëtare.

Neni 3

Shkurtesa

Në këtë rregullore shkurtesat e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. MAS është Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë.
2. MASHTI është Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës.
3. AKAP është Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar.
4. ZVAP është Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare.
5. DKA është Drejtoria Komunale e Arsimit.
6. KM është Komisioni Mbikëqyrës, i cili administron dhe mbikëqyr procesin e zhvillimit të olimpiadës. Në këtë komision nuk mund të përfshihen mësues të gjuhës shqipe.
7. KV është Komisioni Vlerësues, i cili vlerëson përgjigjet e nxënësve. Në këtë komision marrin pjesë mësues të gjuhës shqipe.
8. KHT është Komisioni i Hartimit të Testeve, i cili harton pyetjet e testit. Në këtë komision marrin pjesë mësues të gjuhës shqipe.

Neni 4

Zhvillimi i olimpiadës

1. Olimpiada zhvillohet në katër faza:
 - a) Faza parë zhvillohet në nivel shkolle;
 - b) Faza e dytë zhvillohet në nivel ZVAP-i/DKA-je.
 - c) Faza e tretë zhvillohet në nivel shteti.

- ç) Faza e katërt zhvillohet në nivel ndërshtetëror mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.
2. Data dhe vendi i zhvillimit të secilës fazë të olimpiadës, përcaktohet urdhër/vendim të përbashkët të ministruave përgjegjës për arsimin, për çdo vit shkollor që do të realizohet.
 3. Olimpiada në të gjitha fazat e saj realizohet me shkrim.
 4. Testet me shkrim në të gjitha fazat e olimpiadës bazohen në kornizën e programeve të gjuhës shqipe të miratuar nga MAS-i/MASHTI.
 5. Testi duhet të përmbajë 50 pikë.
 6. Testimi në çdo fazë të olimpiadës zgjat 2 orë.

Neni 5

Kriteret për pjesëmarrjen e nxënësve në olimpiadë

1. Në fazën e parë marrin pjesë nxënësit të cilët notën në lëndën e gjuhës shqipe, në klasën pararendëse e kanë të paktën 8 (tetë) për Republikën e Shqipërisë dhe të paktën 3 (tre) për Republikën e Kosovës.
2. Në fazën e dytë, të tretë dhe të katër marrin pjesë nxënësit që kanë fituar të paktën 65% të pikëve të testimit të fazës pararendëse.
3. Pjesëmarrja e nxënësve në çdo fazë të olimpiadës bëhet me miratim të personave që ushtrojnë përgjegjësitë prindërore.

Neni 6

Shpallja e nxënësve fitues

Në përfundim të çdo faze të olimpiadës, shpallen fituesit si më poshtë:

- a) Fitues të vendit të parë vlerësohen nxënësit që kanë fituar nga 85% deri në 100% të pikëve totale të testit.
- b) Fituesit e vendit të dytë vlerësohen nxënësit që kanë fituar nga 75% deri në 84% të pikëve totale të testit.
- c) Fituesit e vendit të tretë vlerësohen nxënësit që kanë fituar nga 65% deri në 74% të pikëve totale të testit.

Neni 7

Certifikimi i fituesve

Pajisja me certifikatë e fituesve bëhet si më poshtë:

- a) Nxënësit fitues të olimpiadës në fazën e parë pajisen me certifikata nga drejtoritë e shkollave përkatëse;
- b) nxënësit fitues të olimpiadës në fazën e dytë pajisen me certifikata nga ZVAP-i/DKA-ja;
- c) nxënësit fitues të olimpiadës në fazën e tretë pajisen me certifikata nga MAS-i/MASHTI.
- ç) nxënësit pjesëmarrës të secilit shtet në fazën IV, pajisen me certifikatë pjesëmarrjeje nga ministria përkatëse;
- d) nxënësit fitues të vendit I-rë, II-të dhe III-të, të fazës IV, pajisen me certifikatë nga ministria përkatëse.
- e) certifikata për fazën IV, është sipas formatit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 8

Detyrat dhe përgjegjësitë e institucionit arsimor parauniversitar (shkollës)

Detyrat dhe përgjegjësitë e institucionit arsimor parauniversitar (shkollës), për realizimin e fazës së parë të olimpiadës, janë:

- a) Informojnë nxënësit, mësuesit dhe prindërit për zhvillimin e olimpiadës së përbashkët të gjuhës shqipe për klasën e 9-të, duke njohur ata me rregulloren për zhvillimin e olimpiadës, me kornizën e programit të gjuhës shqipe, mbi bazën e të cilave do të realizohet olimpiada e përbashkët.
- b) Organizojnë punën me mësuesit e gjuhës shqipe, për përgatitjen e nxënësve për pjesëmarrje në të gjitha fazat e olimpiadës.
- c) Shpallin në ambientet e shkollës datën dhe orën e zhvillimit të olimpiadës, e përcaktuar nga MAS-i/MASHTI.
- ç) Përcaktojnë mjedisin brenda shkollës, në të cilin do të realizohet olimpiada.
- d) Krijon komisione në nivel shkolle për mbikëqyrjen e procesit të zhvillimit të olimpiadës (KM) dhe vlerësimin e përgjigjeve të nxënësve (KV).
- dh) Një javë para zhvillimit të fazës së parë të olimpiadës, dërgon në ZVAP/DKA listën e nxënësve që do të marrin pjesë në olimpiadë, sipas kriterëve të vendosura në këtë rregullore.
- e) Drejtori i shkollës, një ditë para zhvillimit të olimpiadës, merr në dorëzim nga ZVAP-i/DKA-ja testet e nxënësve, të mbyllura në zarf dhe të vulosura me vulën e ZVA-së/DKA-së.
- ë) Testet e nxënësve hapen nga drejtori i shkollës në fillim të olimpiadës, para nxënësve pjesëmarrës dhe komisionit mbikëqyrës.
- f) Në përfundim të olimpiadës, KM grumbullon testet e nxënësve dhe ia dorëzon me procesverbal drejtorit të shkollës.
- g) Drejtori i shkollës nëpërmjet KV organizon punën për vlerësimin e përgjigjeve të nxënësve, shpalljen e rezultateve dhe dërgimin zyrtarisht në ZVAP/DKA të listës së nxënësve fitues sipas kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore, jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i fazës së parë.
- gj) Administron ankesat e nxënësve për fazën e parë dhe i kërkon KV shqyrtimin e ankesave.

Neni 9

Detyrat dhe përgjegjësitë e ZVAP-it/DKA-së

Detyrat dhe përgjegjësitë e ZVAP-it/DKA-së, për realizimin e fazës së dytë të olimpiadës janë:

- a) Shpallin në ambientet e ZVAP-it/DKA-së dhe të çdo institucioni arsimor, datën, orën dhe vendin për zhvillimin e fazës së dytë të olimpiadës, e përcaktuar nga MAS-i/MASHTI.
- b) Me urdhër të drejtorit të ZVAP-it/DKA-së, krijon KHT me mësues të lëndës së gjuhës shqipe, për hartimin e testit të fazës së parë dhe të dytë, si dhe KV për vlerësimin e përgjigjeve të testeve të fazës së dytë.

- c) KHT të testeve, tri ditë pune para datës së zhvillimit të secilës fazë të olimpiadës, i dorëzon drejtorit të ZVAP/DKA testin e përgatitur për secilën fazë.
- ç) Krijon komisione në nivel ZVAP-i/DKA-je për mbikëqyrjen e procesit të zhvillimit të olimpiadës dhe vlerësimin e përgjigjeve të nxënësve.
- d) Përgatitin listën e nxënësve që do të marrin pjesë në fazën e dytë të olimpiadës, në bazë të shkresave zyrtare të dërguara nga drejtoritë e shkollave, për fituesit e fazës së parë në nivel shkolle.
- dh) Sigurohet që institucionet arsimore (shkollat) kanë njoftuar për pjesëmarrjen në fazën e dytë të olimpiadës nxënësit pjesëmarrës dhe personat që ushtrojnë përgjegjësi prindërore.
- e) Dërgon zyrtarisht në çdo shkollë testin për fazën e parë. Testet duhet të jenë të mbyllura në zarf për çdo shkollë, për aq nxënës sa do të marrin pjesë në fazën e parë të olimpiadës.
- ë) I dorëzon kryetarit të mbikëqyrjes së testimit të fazës së dytë, zarfin me testin e përgatitur nga KHT për këtë fazë, për aq nxënës sa do të marrin pjesë në këtë fazë të olimpiadës, si edhe listën e nxënësve pjesëmarrës.
- f) Përgatitin listën e nxënësve fitues të fazës së dytë dhe i dërgon zyrtarisht në MAS/MASHTI.
- g) Administron ankesat e nxënësve për fazën e dytë dhe i kërkon KV shqyrtimin e ankesave.

Neni 10

Detyrat dhe përgjegjësitë e AKAP

Koordinon punën me ZVAP-in për organizimin dhe realizimin në kohë dhe me përgjegjësi të të gjitha detyrave të përcaktuara për ZVAP-in në këtë rregullore.

Neni 11

Detyrat dhe përgjegjësitë e grupeve të punës në MAS/MASHTI

Detyrat dhe përgjegjësitë e grupeve respektive të punës të MAS-it/MASHTI-t, për realizimin e olimpiadës së përbashkët janë:

- a) Koordinimi me AKAP-in/ZVAP-in/DKA-në për realizimin e detyrave të përcaktuara në këtë rregullore, për zhvillimin me sukses të të gjitha fazave të olimpiadës së përbashkët të gjuhës shqipe, klasa 9-të.
- b) Mbikëqyrja/administrimi nga grupet respektive të punës të secilit shtet, i listës së nxënësve fitues të olimpiadës të fazës së dytë, sipas shkresave zyrtare të dërguara respektivisht nga ZVAP-i/DKA-ja. Përgatitja e listës së nxënësve që do të marrin pjesë në fazën e tretë.
- c) Krijimi i KHT dhe KV me mësues të gjuhës shqipe të secilit shtet, për hartimin dhe vlerësimin e testeve të olimpiadës së fazës së tretë.
- ç) Krijimi i KHT dhe KV të përbashkët me mësues të gjuhës shqipe nga të dy shtetet, për hartimin dhe vlerësimin e testeve të fazës së katërt.
- d) Krijimi i KM për zhvillimin e testimit në fazën e tretë në nivel shteti.
- dh) Krijimi i KM për fazën e katër, i cili do të përbëhet nga mësues të shtetit ku do të organizohet olimpiada.
- e) Njoftimi i çdo nxënësi dhe personit që ushtron përgjegjësinë prindërore, për datën, orën, vendin

e zhvillimit të fazës së tretë të olimpiadës, nëpërmjet AKAP-it/ZVAP-it/DKA-së, respektivisht drejtorive të institucioneve arsimore (shkollave).

- ë) Marrja në dorëzim nga KH i testeve të fazës së tretë dhe të katër, jo më vonë se një ditë para zhvillimit të olimpiadës.
- f) Dorëzimi në zarf të mbyllur kryetarit të KM të testit të fazës së tretë dhe të katër. Në zarf duhet të jenë aq teste sa nxënës do të marrin pjesë në secilën fazë. Në zarf të ketë edhe një test rezervë.
- g) Mbikëqyrin procesi e testimit të olimpiadës të fazës së tretë dhe të katër.
- gj) Marrja me procesverbal nga KM të testeve të nxënësve për fazën e tretë e të katër. Testet e nxënësve i dorëzohen me procesverbal KV.
- h) Pas vlerësimit të përgjigjeve të nxënësve nga KV të fazës së tretë dhe të katër, zbardhen rezultatet e nxënësve dhe i dërgohen çdo institucioni arsimor (shkolle) për të njoftuar nxënësit.
- i) Administron ankesat e nxënësve për fazën e tretë dhe të katër dhe i kërkon KV shqyrtimin e ankesave.
- j) Mbi bazën e rezultateve të fazës së tretë, hartojnë listën e nxënësve fitues që do të marrin pjesë në fazën e katër të olimpiadës për secilin shtet dhe e paraqesin zyrtarisht në MAS/MASHTI.
- k) Krijojnë një grup pune me 3-5 mësues/drejtimes, për të shoqëruar nxënësit fitues të fazës së tretë të olimpiadës, të cilët do të marrin pjesë në fazën e katër dhe do të udhëtojnë për në Shqipëri-Kosovë dhe anasjelltas. Për këta nxënës duhet të merret miratimi i personave që ushtrojnë përgjegjësitë prindërore.
- l) Përgatisin certifikatat për fazën e katër.
- ll) Grupi i punës i shtetit ku do të zhvillohet faza e katërt e olimpiadës do të marrë masa për organizimin e ceremonisë së nderimit të nxënësve pjesëmarrës dhe të nxënësve fitues dhe përgatitjen e certifikatave të pjesëmarrjes dhe të certifikatave për vendin e parë, të dytë dhe të tretë.

Neni 13

Konflikti i interesit

Hartuesit e pyetjeve të testit, vlerësuesit e përgjigjeve të nxënësve dhe mbikëqyrësit e procesit të testimit, deklarojnë me shkrim që nuk kanë konflikt interesi.

Neni 14

Ankimimi

1. Nxënësit pjesëmarrës në secilën fazë të olimpiadës ose personat që ushtrojnë përgjegjësitë e tyre prindërore, kanë të drejtë të paraqesin ankesë me e-mail ose me shkrim, për vlerësimin e bërë, brenda dy ditëve nga shpallja e rezultateve.
2. KV të testeve të secilës fazë shqyrtojnë brenda dy ditëve ankesat e nxënësve dhe i njoftojnë për rezultatin përfundimtar. Njoftimi bëhet më të njëjtën formë me të cilën është paraqitur ankesa.

Neni 15

Raportimi

Grupi i përbashkët i punës, në përfundim të të gjitha fazave të olimpiadës, harton raportin

përfundimtar të veprimtarisë së kryer. në të cilin jep vlerësimet mbi mbarëvajtjen e saj dhe rekomandime për vitin vijues.

Neni 16

Financimi

1. Shpenzimet financiare për hartuesit dhe vlerësuesit e testeve në fazën e parë dhe të dytë mbulohen nga buxheti i ZVAP-it/DKA-së.
2. Shpenzimet financiare për hartuesit dhe vlerësuesit e testeve në fazën e tretë dhe të katërt mbulohen nga buxhetet e MAS-it/MASHTI-t.
3. Shpenzimet për transportin mbulohen nga buxhetet e MAS-it/MASHTI-t.
4. Shpenzimet për akomodimin dhe ushqimin e pjesëmarrësve në olimpiadë dhe të grupeve të punës për fazën e katër mbulohen nga pala pritëse (MAS ose MASHTI).

Shtojca nr. 4

KORNIZË E PËRBASHKËT E PROGRAMEVE TË GJUHËS SHQIPE

(Për realizimin e olimpiadës në lëndën e gjuhës shqipe, me nxënësit e klasave të nënta në Kosovë dhe në Shqipëri)

Korniza e përbashkët e programeve të gjuhës shqipe u hartua nga grupi i punës, i përbërë nga ekspertë, specialistë të kurrikulës, mësues të gjuhës shqipe në arsimin parauniversitar në Kosovë dhe në Shqipëri. Korniza u bazua në rezultatet e të nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët.

Tiranë–Prishtinë, 2024

Përmbajtja

I. HYRJE.....	3
II. QËLLIMET E OLIMPIADËS.....	4
III. NJOHURITË DHE SHKATHTËSITË GJUHËSORE.....	4
IV. RUBRIKAT E TESTIT TË OLIMPIADËS.....	13

Shkurtime

DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
ZVAP	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

I. HYRJJE

Olimpiadat në shkollë janë të rëndësishme, sepse i motivojnë nxënësit që të zhvillojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre dhe të konkurrojnë në mënyrë të shëndetshme. Konkurrenca në olimpiada mes nxënësve:

- nxjerr në pah aftësitë dhe talentet e nxënësve;
- edukon disiplinë dhe etikë;
- nxit dhe zhvillon pasionet;
- krijon emocione pozitive;
- i mëson nxënësit jo vetëm të përballen me sfida dhe me probleme, por edhe t'i zgjidhin ato;
- ndërton vetëbesimin te nxënësit dhe i bën ata krijues.

Këtë natyrë ka edhe olimpiada e përbashkët në lëndën e gjuhës shqipe, me nxënësit e klasave të nënta në Kosovë dhe në Shqipëri. Olimpiada organizohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) në Shqipëri dhe nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) në Kosovë. Ajo është gjithëpërfshirëse, pasi në të angazhohen të gjithë nxënësit e klasave të nënta që kanë rezultate të larta në lëndën e gjuhës shqipe. Zhvillimi i olimpiadës gjallëron jetën në shkolla dhe frymën e garës së shëndetshme mes nxënësve.

Synimi i olimpiadës është që nxënësit të thellojnë dashurinë për gjuhën shqipe e nëpërmjet saj edhe dashurinë dhe përkushtimin për kombin. Olimpiada do të promovojë krijimtarinë; aftësitë e analizës, të mendimit kritik dhe të zgjidhjes problemore; përdorimin e njohurive dhe shkathtësive gjuhësore.

Për të orientuar mësuesit e gjuhës shqipe dhe drejtuesit e shkollave në punën e tyre për përgatitjen e nxënësve për olimpiadë, si dhe specialistët e ZVAP-ve/DKA-ve që do të mbështesin dhe do të organizojnë konkursin në nivel shkolle dhe në nivel ZVAP-je/DKA-je, është hartuar *Korniza e përbashkët për realizimin e olimpiadës në lëndën e gjuhës shqipe (më poshtë olimpiadë), me nxënësit e klasave të nënta*. Në *Kornizë* janë trajtuar çështjet e mëposhtme:

- Qëllimet e olimpiadës;
- Njohuritë dhe shkathtësitë gjuhësore;
- Rubrikat e testit të olimpiadës.

Hartimi i *Kornizës së përbashkët për realizimin e olimpiadës në lëndën e gjuhës shqipe, me nxënësit e klasave të nënta* është mbështetur në Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet MAS-it të Republikës së Shqipërisë dhe MASHTI-t të Republikës së Kosovës, datë 05.07.2023.

II. QËLLIMET E OLIMPIADËS

Qëllimet e olimpiadës janë:

- Zhvillimi i aftësive të nxënësve për të lexuar dhe për të shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi i mendimit kritik e krijues nëpërmjet këtyre teksteve.
- Vlerësimi i krijimtarisë së shkrimtarëve të letërsisë shqipe, përfaqësues të periudhave të ndryshme;
- Zotërimi i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të duhura rreth sistemit gjuhësor të shqipes.
- Vlerësimi i gjuhës shqipe si vlerë e kulturës sonë kombëtare dhe si mjet komunikimi.

III. NJOHURITË DHE SHKATHTËSITË GJUHËSORE

Për të orientuar punën e mësuesve në përgatitjen e nxënësve për pjesëmarrjen në olimpiadë, në tabelat e mëposhtme janë përcaktuar njohuritë dhe shkathtësitë gjuhësore, të cilat do të vlerësohen në të gjitha fazat e realizimit të olimpiadës.

TË LEXUARIT	
Njohuritë	Shkathtësitë
<ul style="list-style-type: none">- Tekstet letrare dhe joletrare. Dallimet kryesore mes tyre.- Tema kryesore ose motivi kryesor.- Idetë dhe informacionet e tekstit.- Struktura dhe forma e tekstit. <p>Tekstet të ndryshme letrare: tekste poetike dhe tekste në prozë. Tiparet kryesore të tyre.</p> <ul style="list-style-type: none">- Gjuha e figurshme. Figurat stilistike: simboli, krahasimi, metafora,	<p>Të lexuarit për të analizuar dhe për të vlerësuar tekstin¹</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">- demonstroi një kuptim të plotë dhe të detajuar të një ose më shumë teksteve;- integron informacionin nga më shumë se një tekst dhe e lidh me jetën e përditshme dhe/ose me përvojën e tij;- interpreton tekstin dhe jep argumente dhe shembuj që mbështesin interpretimin e tij;

¹ Këto shkathtësi janë të përbashkëta për tekstet letrare dhe joletrare.

metonimia, sinekdoka, personifikimi, hiperbola, litota, aliteracioni, similituda, eufemizmi, epiteti, alegoria, antiteza (kundërvënia), përsëritjet, ironia, sarkazmi.

- *Teksti poetik*: Rima dhe strofat në një tekst poetik. Tiparet kryesore të stilit dhe të gjuhës në një tekst poetik.
- *Teksti në prozë*: Tiparet kryesore të disa teksteve në prozë (përralla, fabula, tregimi, romani). Subjekti i një proze. Analiza e personazhit. Rrëfimtari.

Tekstet joletrare: përshkrime, rrëfime, tekste informuese, kronika, biografi, kujtime, intervista, ditarë, letra, reklama, fjalime, ese.

- Tiparet kryesore të teksteve joletrare.

- bën krahasime që janë të detajuara dhe të sakta;
- formulon konkluzione rreth ideve, strukturës, gjuhës dhe stilit të teksteve;
- vlerëson në mënyrë kritike një tekst mbi një temë të panjohur, duke marrë në konsideratë këndvështrime të ndryshme;
- identifikon qëllimin e autorit dhe lexuesin/it e tekstit;
- dallon faktin nga opinioni;
- dallon shkakun nga pasojat në një tekst;
- dallon problemin dhe zgjidhjen e problemit në një tekst;
- përmbledh idetë dhe mban qëndrim kritik ndaj tyre;
- zbulon mesazhin e një teksti të dhënë;
- analizon funksionin e veçorive kryesore të gjuhës së tekstit;
- interpreton dhe përcakton funksionin e disa elementeve të teksteve, si: grafikët, tabelat, imazhet, ilustrimet etj.;
- përshkruan se si ndikon teksti në botën emocionale ose në mendimet e tij.

Të lexuarit e teksteve letrare

Nxënësi:

- grupon tekstet që lexon sipas gjinive dhe llojeve letrare;
- përshkruan dhe analizon kohën, vendin, mjedisin dhe ngjarjet, duke dhënë detaje nga teksti;

- përcakton funksionin e figurave stilistike, si: *simboli, krahasimi, metafora, metonimia, sinekdoka, personifikimi, hiperbola, litota, aliteracioni, similituda, eufemizmi, epiteti, alegoria, antiteza (kundërvënia), përsëritjet, ironia, sarkazmi.*

Teksti poetik

Nxënësi:

- analizon atmosferën që krijon poezia;
- dallon motivet;
- dallon tiparet kryesore të metrikës, si llojin e rimës dhe të strofës, në poezi, si dhe shpjegon funksionin e tyre;
- dallon vargun e lirë në një poezi dhe shpjegon funksionin e tij;
- analizon dhe shpjegon funksionin e elementeve të stilit dhe të gjuhës në një tekst poetik;
- dallon, analizon dhe vlerëson disa lloje tekstesh poetike, si: soneti, himni, elegjia etj.

Teksti në prozë

Nxënësi:

- dallon temën kryesore;
- analizon tiparet kryesore të disa teksteve në prozë, si: tregimi, romani, përralla, fabula, proza poetike;
- analizon personazhet, duke u përqendruar: te fjalët e autorit për personazhin, te fjalët, veprimet, mendimet e tij, te marrëdhëniet me personazhet e tjera;

- sjell përvojat e tij të ngjashme me ato të personazheve të një tregimi, romani etj.;
- dallon mënyrën e rrëfimit në një tregim, roman etj., dhe shpjegon funksionin e saj;
- dallon rrëfimtarin në një tekst.

Të lexuarit e teksteve joletrare

Nxënësi:

- analizon dhe vlerëson ngjarjet dhe çështjet kryesore në tekste nga kultura dhe kohë të ndryshme, si: përshkrime, rrëfime, tekste informuese, kronika, biografi, kujtime, intervista, ditarë, letra, reklama, fjalime, ese;
- analizon elementet e tekstit, si: tema, paragrafi, hyrja, përfundimet, citimi, bibliografia;
- dallon argumentet *pro* dhe *kundër* një çështjeje në një tekst dhe i vlerëson ato.

TË SHKRUARIT

Njohuritë

- Ese argumentuese për gjuhën dhe për kulturën shqipe.
- Tekste letrare në poezi dhe në prozë.
- Shkrime rrëfyese, si: përvoja vetjake, ngjarje të lexuara ose të dëgjuara.
- Shkrime përshkruese, si: përshkrime të natyrës, përshkrime të miqve, të personazheve ose të personaliteteve në

Shkathësitë

Procesi i të shkruarit²

Nxënësi:

- organizon idetë kryesore duke i ilustruar dhe duke i mbështetur me detaje, shembuj, fakte dhe opinione të ndryshme;
- respekton strukturën e punës me shkrim;
- përshtat gjuhën me llojin e punës me shkrim, me qëllimin dhe me lexuesin;

² Këto shkathësi janë të përbashkëta për të gjitha llojet e teksteve që shkruajnë nxënësit.

<p>fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Teksti udhëzues, si: rregullore, udhëzime. - Intervistë. - Letër formale dhe joformale. - Fjalim i shkurtër. 	<ul style="list-style-type: none"> - përzgjedh fjalët dhe frazat që i japin punës ose detyrës me shkrim gjallëri dhe shprehësi; - përdor lloje të ndryshme fjalish (lloj, gjatësi, strukturë) për të përmirësuar rrjedhën dhe cilësinë e punës me shkrim; - përdor gjuhën standarde shqipe gjatë të shkruarit; - zbaton njohuritë gramatikore dhe drejtshkrimore gjatë të shkruarit; <p>Të shkruarit për qëllime personale</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan rrëfime personale duke reflektuar mbi veten, mbi përvojat personale, mbi ngjarjet e kaluara etj.; - shkruan tregime nga bota reale ose imagjinare për tema që janë interesante; - krijon, analizon dhe vlerëson tekste të ndryshme në prozë dhe në poezi; - përshkruan dhe analizon personazhet/personalitetet e tij të pëlqyera dhe argumenton pëlqimin e tij. <p>Të shkruarit për qëllime funksionale</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan tekste udhëzuese, si: rregullore, udhëzime; - njeh dhe zbaton hapat e realizimit të një interviste;
---	--

	<ul style="list-style-type: none"> - shkruan letra për qëllime dhe lexues të ndryshëm; - shkruan një fjalim të shkurtër.
--	--

SISTEMI GJUHËSOR

Njohuritë

Shkathësitë

Sintaksë

- Llojet e fjalive sipas kumtimit.
- Fjalitë njëkryegjymtyrëshe dhe dykryegjymtyrëshe. Fjalitë njëkryegjymtyrëshe foljore. Fjalitë njëkryegjymtyrëshe emërore.
- Fjalitë e thjeshtë dhe fjalitë e përbërë.
- Fjalitë e përbëra me bashkërenditje.
- Fjalitë e përbëra me nënrenditje.
- Gjymtyrët kryesore (kryefjala dhe kallëzuesi).
- Gjymtyrët e dyta (përcaktori, kundrinori, rrethanori, përcaktori kallëzuesor). Llojet.
- Ligjërata e drejtë dhe ligjërata e zhdrejtë.

Sintaksë

Nxënësi:

- përcakton llojin e fjalisë sipas kumtimit dhe argumenton përgjigjen e tij;
- ndërton dhe analizon fjali të ndryshme dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore;
- dallon llojin e fjalisë sipas ndërtimit (përbërjes) dhe argumenton përgjigjen e tij;
- dallon fjalinë dykryegjymtyrëshe dhe fjalinë njëkryegjymtyrëshe, si dhe argumenton përgjigjen e tij;
- dallon dhe ndërton fjali njëkryegjymtyrëshe foljore dhe emërore, si dhe argumenton përgjigjen e tij;
- dallon fjalinë e thjeshtë nga fjalitë e përbërë dhe argumenton përgjigjen e tij;
- përcakton llojin e fjalisë së përbërë me bashkërenditje dhe me nënrenditje, si dhe argumenton përgjigjen e tij;
- ndërton fjali të ndryshme me bashkërenditje dhe me nënrenditje;
- ndërton skemën e një fjalie të përbërë;

	<ul style="list-style-type: none"> - dallon funksionet gramatikore të gjymtyrëve (kryefjalë, kallëzues, përcaktor, përcaktor kallëzuesor, kundrinor, rrethanor) në një fjali të dhënë dhe përcakton se me çfarë shprehen; - përcakton llojet e kundrinorëve dhe argumenton përgjigjen e tij; - përcakton llojet e përcaktorëve dhe argumenton përgjigjen e tij; - përcakton llojet e rrethanorëve dhe argumenton përgjigjen e tij; - përdor në fjali kundrinorin, përcaktorin, përcaktorin kallëzuesor dhe rrethanorin; - kthen ligjëratën e drejtë në ligjëratë të zhdrejtë dhe anasjellas.
<p>Morfologji</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fjalët e ndryshueshme dhe fjalët e pandryshueshme. - Kategoritë gramatikore të emrit. - Kategoritë gramatikore të mbiemrit. - Kategoritë gramatikore të foljes. - Format e pashtjelluara të foljes. Llojet. - Përemrat. Llojet. Kategoritë gramatikore. Trajtat e shkurtra dhe të bashkuara. - Ndajfoljet. Llojet. - Lidhëzat. Llojet. - Parafjalët sipas rasave. 	<p>Morfologji</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon klasat e fjalëve dhe argumenton përgjigjen e tij; - analizon kategoritë gramatikore të emrit dhe argumenton përgjigjen e tij; - analizon kategoritë gramatikore të mbiemrit dhe argumenton përgjigjen e tij; - analizon kategoritë gramatikore të foljeve dhe argumenton përgjigjen e tij; - dallon dhe përdor format e pashtjelluara; - analizon funksionet e formave të pashtjelluara; - përcakton llojin e përemrave dhe argumenton përgjigjen e tij; - analizon kategoritë gramatikore të përemrave të ndryshëm;

	<ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe përdor trajtat e shkurtra dhe të bashkuara (tri pozicionet); - gjen ndajfoljet dhe përcakton llojin e tyre, si dhe argumenton përgjigjen e tij; - dallon lidhëzat dhe përcakton llojin e tyre, si dhe argumenton përgjigjen e tij; - dallon parafjalët sipas rasave dhe argumenton përgjigjen e tij.
Fjalëformim <ul style="list-style-type: none"> - Fjala dhe përbërësit e saj. - Fjalët e thjeshta dhe fjalët jo të thjeshta. - Mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe. - Fjalët e prejardhura. - Fjalët e përbëra. - Fjalët e përngjitura. 	Fjalëformim Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - analizon përbërësit e fjalës; - dallon fjalët e thjeshta nga fjalët jo të thjeshta dhe argumenton përgjigjen e tij; - përcakton mënyrën e formimit të fjalëve dhe argumenton përgjigjen e tij; - dallon fjalët e prejardhura dhe përcakton llojin e tyre; - formon fjalë të prejardhura; - dallon dhe formon fjalë të përbëra; - dallon dhe analizon fjalë të përngjitura.
Leksikologji <ul style="list-style-type: none"> - Gjuha standarde shqipe. - Huazimet. - Dialektet e gjuhës shqipe. - Kuptimet e fjalëve. - Kuptimi i figurshëm i fjalëve. - Familja e fjalëve. - Sinonimet dhe antonimet. - Shprehjet frazeologjike. - Fjalët e urta. 	Leksikologji Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - përdor gjuhën standarde gjatë të folurit dhe të shkruarit; - dallon fjalët dialektore dhe vlerëson dialektet si pasuri leksikore të gjuhës shqipe; - shmang fjalët e huaja gjatë të shkruarit; - përcakton dhe analizon kuptimet e fjalës; - dallon kuptimin e figurshëm të fjalës; - ndërton familjen e fjalëve të ndryshme, jo më pak se katër fjalë;

	<ul style="list-style-type: none"> - krijon çifte sinonimie dhe antonimie; - dallon dhe përdor në fjali fjalët e urta; - dallon dhe përdor në fjali shprehjet frazeologjike.
Histori e gjuhës shqipe <ul style="list-style-type: none"> - Gjuha shqipe dhe vendi i saj në familjen e gjuhëve indoevropiane. - Dëshmitë, dokumentet e para të shkrimit të shqipes dhe libri i parë në gjuhën shqipe. - Kongresi i Manastirit dhe ai i Elbasanit, vendimet më të rëndësishme të tyre. - Kongresi i Drejtshkrimit. 	Histori e gjuhës shqipe Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - vlerëson lashtësinë e gjuhës shqipe si pjesë e familjes së gjuhëve indoevropiane; - analizon dhe vlerëson dokumentet e para të shkrimit të shqipes; - analizon dhe vlerëson vendimet më të rëndësishme të Kongresit të Manastirit dhe të Kongresit të Elbasanit; - analizon dhe vlerëson vendimet më të rëndësishme të Kongresit të Drejtshkrimit.
Drejtshkrim <ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i shenjave të pikësimit. - Përdorimi i apostrofit. - Drejtshkrimi i shkronjës së madhe. - Drejtshkrimi i përemrave, ndajfoljeve, parafjalëve, numërorëve dhe pjesëzave sipas rregullave të drejtshkrimit. - Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në trup dhe në fund të fjalës. - Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve nistore: <i>sh, zh, ç, s, z</i>. - Drejtshkrimi i zanoreve: <i>e, ë, i/y, u/y</i>. - Drejtshkrimi i fjalëve që përmbajnë grupet e zanoreve: <i>ye, ua, ie</i>. - Drejtshkrimi i fjalëve që mbarojnë me: <i>-ër, -ërr, -ël</i> në shumës. 	Drejtshkrim Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - përdor saktë shenjat e pikësimit brenda dhe në fund të fjalisë, si dhe argumenton përgjigjen e tij; - përdor drejt apostrofin dhe argumenton përgjigjen e tij; - përdor saktë shkronjën e madhe dhe argumenton përgjigjen e tij; - shkruan saktë përemrat, ndajfoljet, parafjalët, numërorët dhe pjesëzat sipas rregullave të drejtshkrimit, si dhe argumenton përgjigjen e tij; - shkruan drejt bashkëtingëlloret e zëshme në trup dhe në fund të fjalës;

- përdor saktë bashkëtingëlloret nistore: *sh, zh, ç, s, z*;
- përdor drejt zanoret: *e, ë, i/y, u/y* në fjalë të ndryshme;
- shkruan saktë fjalët që përmbajnë grupet e zanoreve: *ye, ua, ie*;
- shkruan drejt fjalët që mbarojnë me: *-ër, -ërr, ël* në shumës.

IV. RUBRIKAT E TESTIT TË OLIMPIADËS

Testi i olimpiadës do të përmbajë:

- Analizë dhe vlerësim të teksteve letrare dhe joletrare;
- Ese argumentuese me tematikë për gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare;
- Shkrime tekstesh letrare ose joletrare;
- Pyetje/kërkesa për përdorimin e njohurive të sistemit gjuhësor;
- Pyetje/kërkesa për analizën dhe vlerësimin e zhvillimit historik të gjuhës shqipe.

Pyetjet ose kërkesat në testin e olimpiadës do të jenë të tri niveleve. Tabela e mëposhtme paraqet përqindjen e pikëve në testin e olimpiadës për secilin nivel.

Niveli bazë	Niveli mesatar	Niveli i lartë
20%	40%	40%
<i>Njohja dhe të kuptuarit</i>	<i>Zbatimi dhe analiza</i>	<i>Vlerësimi dhe krijimi</i>